



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:129209
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06490458

Ac.nr.6431/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ylber Shurdhiqi, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Fatmir Baloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizimit e përfaqëson Kompania “Debt Loan Recovery Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit A.Sh., nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson V.O., avokat nga Prizreni, lidhur me çështjen juridike rimbursim dëmi, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.898/2019, të datës 26.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit A.Sh., nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.898/2019, të datës 26.07.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.898/2019, të datës 26.07.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri A.Sh., nga P., që t’ia rimburoj paditësit dëmin në shumën prej 1,859.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në ditën e pagesës definitive të mjeteve, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. II. OBLIGOHET i padituri A. Sh. që paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet ankesa e të paditurit dhe të ndryshoj aktgjykimin e atakuar, duke e refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses apo çështja të kthehet në rigjykim në shkallën e parë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me padinë e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensoj shumën prej 1,859.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 27.12.2016 në Prizren, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe t'i paguaj edhe shpenzimet gjyqësore të cilat do t'i caktoj gjykata, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, të cekura në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.898/2019, të datës 26.07.2022, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, duke pasur parasysh provat e administruara si dhe fakte të vërtetuara, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsytet se nuk ishte kontestuese se i padituri Asllan Shala nga Prizreni, më datë 27.12.2016 rreth orës 12:35, me automjetin e tij Audi A6, me targa të regjistrimit, ka shkaktuar aksident trafiku, në Komunën e Prizrenit, me ç'rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku, duke ardhur përderisa automjeti Audi A6 ka qenë në lëvizje në rrugën e lartcekur me një shpejtësi të madhe ku me pjesën ballore e godet automjetin B "Golf" në pjesën e pasme e përplas atë në automjetin C, në pjesën e pasme. Po ashtu, në këtë aksident lëndime në njerëz nuk ka pasur, respektivisht i padituri A. Sh. ka qenë duke e ngarë automjetin që është në emër të tjetër kujt, nuk ka qenë automjeti i vetë. Përmes ujdisë jashtë gjyqësore Byroja Kosovare e Sigurimit në emër të kompensimit të të gjitha formave të dëmit material dhe jo material, ia ka kompensuar të dëmtuarave Auto Shkolla Malisheva në shumën e përgjithshme prej 1,479.00 euro dhe të dëmtuarit A. J. në shumën e përgjithshme prej 380,00 euro. Për bazë ligjore i është referuar nenit 14 par. 1 nën par. 1.2. dhe par. 2 dhe 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nenit 960 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore e ka bazuar në nenin 450 dhe 452 par. 1 të LPK-së, (më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe

Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditëses, e parashtruar kundër të paditurit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin, përkatësisht aktgjykimi është hartuar në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Për sa i përket pretendimit ankimor për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, që i referohen aprovimit të kërkesëpadisë, për shkak se nuk është vërtetuar baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë bazën juridike të kërkesëpadisë e ka vërtetuar përmes raportit të aksidentit nr. 2016.....të datës 27.12.2016, ku sipas këtij raporti është vërtetuar se automjeti Audi A6 ka qenë në lëvizje në rrugën e lartcekur me një shpejtësi të madhe ku me pjesën ballore e godet automjetin B “Golf” në pjesën e pasme e përplas atë në automjetin C, në pjesën e pasme, andaj aksidenti shkaktonte dëme të konsiderueshme materiale tek automjetet, pa pasoja në njerëz, ku shkaktar i këtij aksidenti ka qenë i padituri, ndërsa të dëmtuar nga ky aksident kanë qenë Auto Shkolla “Semafori” dhe A. J. Lartësinë e dëmit e ka vërtetuar nga ujdite jashtë gjyqësore të datave 16.03.2017 dhe 20.04.2017, si dhe nga urdhër transferet bankare të datave 20.04.2017 dhe 27.04.2017, në bazë të të cilit është vërtetuar se pala paditëse e ka paguar shumën e kërkuar sikur se në padi palëve të dëmtuara.

Mbi bazën e të lartcekurave, meqenëse me qëllim të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit, me datë 27.12.2016, paditësja dhe i dëmtuari Auto Shkolla “Semafori”, më datë 16.03.2017 kanë lidhur ujdi jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 1479.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 27.12.2016 në Prizren dhe paditësja me të dëmtuarin A. J., me datë 20.04.2017 kanë lidhur ujdi jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 380.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 27.12.2016 në Prizren, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare të datave 20.04.2017 dhe 27.04.2017, së bashku me listën e pagesave, në emër të kompensimit të dëmit sipas afatit të paraparë me ujdi gjyqësore për çka me nenin 18 para. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia parashihet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Ndërsa parag.4 i nenin 18 të këtij ligji

shprehimisht thotë: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.*

Sa i përket pretendimit ankimore se i padituri nuk ka qenë pronar i veturës, por veturën e ka përdorur vetëm për kryerjen e obligimeve personale i pa vetëdijshëm se pronari i saj nuk ka pasur policë valide të sigurimit, është vlerësim edhe i Gjykata e Apelit se pronari i automjetit nuk ka qenë shkaktues i aksidentit të komunikacionit, përkundër që ishte pronar i veturës. Nga të cekurat si më lartë është vërtetuar se dëmin e ka shkaktuar i padituri dhe me që kompensimin e dëmit palëve të dëmtuara i’u ka përmbushur pala paditëse përmes ujdive jashtëgjyqësore të arritura, atëherë paditëses i lind e drejta të bëjë regresim në shumën që ka paguar, prandaj, i padituri duhet të bëjë pagesën e dëmin që e ka shkaktuar ndaj palëve të treta të cilën e ka paguar pala paditëse, që tani e kërkon me padi nga shkaktuesi i aksidentit këtu i padituri, ngase fakti i regresimit nuk varet prej të qenit pronar i veturës por varet nga shkaktimi i dëmit e këtë dëme i padituri e ka shkaktuar (këtë nuk e konteston as i padituri).

Duke u bazuar në të lartcekurat, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për aprovimin e kërkesëpadsisë së paditëses, për Gjykatën e Apelit rezultoi si i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

Lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat nga neni 450 dhe 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6431/2022 me dt.18.11.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari,
Ylber Shurdhiqi